

Dokumentimi i Arsimit Gjithëpërfshirës në Shqipëri



Arsimi gjithëpërfshirës siguron mbështetje që të gjithë fëmijët të nxënë së bashku pavarësisht nevojave të tyre individuale.

Përfitimet e Arsimit Gjithëpërfshirës

Të gjithë fëmijët përfitojnë nga arsimi gjithëpërfshirës.

- Arsimi gjithëpërfshirës nxit punën individuale ndërsa mundëson që fëmijët të jenë pjesëmarrës aktivë në jetën shkollore sëbashku me bashkëmohatarët e tyre.
- Prindërit e fëmijëve përfshihen në arsimimin e tyre dhe në aktivitetet e shkollave.
- Arsimi gjithëpërfshirës forcon një kulturë shkollore të respektit dhe përkatësisë dhe ofron mundësi për të mësuar rreth ndryshimeve dhe pranimit të dallimeve individuale duke pakësuar ndikimin e fenomeneve të ngacmimit, talljes dhe bulizmit.
- Fëmijët zhvillojnë miqësi me fëmijë të tjerë, me nevoja dhe aftësi të tjera individuale.
- Arsimi gjithëpërfshirës ndikon pozitivisht në vlerësimin dhe diversitetin e komuniteteve ku fëmijët jetojnë si edhe i ndihmon të përfshihen në jetën sociale dhe kulturore të komuniteteve ku ata jetojnë.

Një përmbledhje për Arsimin Gjithëpërfshirës në Shqipëri dhe Rolin e Save the Children

Përkushtimi për të luftuar e mbrojtur të drejtat e fëmijëve me aftësi të kufizuara ka qënë një nga nismat e misionet kryesore të organizatës "Save the Children" që në vitin 1919. Që nga ajo kohë, **Save the Children** ka vazhduar të kontribuojë fuqishëm në mbrojtje të së drejtave të fëmijëve me aftësi të kufizuara. Afërsisht një shekull më vonë, Save the Children ka zhvilluar përjasje të cilat kanë ndikuar dukshëm në politikat e reformave arsimore e sociale të bazuara në të drejtat e fëmijëve me aftësi të kufizuara.

Programi "**Arsim Gjithëpërfshirës**" ishte një nismë ambicioze, vizionare e bazuar në përjasjen e vlerësimin të aftësisë së kufizuar si një çështje e të drejtave të njeriut/ fëmijëve dhe me synim të qartë të realizimit të një procesi reformues të politikave, kulturave dhe praktikave ekzistuese. Përballja me realitetin e arsimimit të fëmijëve me aftësi të kufizuara, vlerësimi i shkollave speciale si alternativa më e mirë e arsimimit të tyre, kultura mbizotëruese e mospranimit të këtyre fëmijëve në kopshte e shkolla etj, ishin paralajmëruese të një pune sfiduese.

Të gjithë fëmijët, duke përfshirë ata me aftësi të kufizuara dhe vështirësi në të nxënë, të jenë pjesë dhe të mirëpritur në shkollë, në moshën e përshtatshme, në klasa të rregullta, të mbështeten për të mësuar, të kontribuojnë dhe të marrin pjesë në të gjitha aspektet e jetës së shkollës.





Gjithashtu, **përfshirja e vogël e fëmijëve me aftësi të kufizuara në arsim**, ishte jo vetëm rezultat i boshllëqeve ligjore dhe institucionale, klimës diskriminuese, kulturës së fshehtës së vështirësive të fëmijës nga prindërit, por edhe e konfuzionit të koncepteve të edukimit **“të integruar”** dhe **“gjithëpërfshirës”**. Koncepti i “gjithëpërfshirjes” si alternativa e krijimit të kushteve të domosdoshme për zhvillimin e potencialeve të fëmijëve me aftësi të kufizuara, vazhdon të ishte pak ose aspak i njohur nga punonjësit e arsimit, prindërit dhe nxënësit sidomos në rrethet ku gjithëpërfshirja pilotohej për herë të parë.

Që prej fillimeve të këtij programi, “Save the Children” ka mbështetur **identifikimin e hershëm të fëmijëve me aftësi të kufizuara**, duke përdorur metodën **“Portage”**. Mësuesit e arsimit parashkollor të trajnuar për të përdorur këtë metodë, vizitonin në familje fëmijët me aftësi të kufizuara, për t'i përgatitur që të vinin të sigurtë në mjediset parashkollore dhe shkollore. Mësuesit që kanë punuar me fëmijët me aftësi të kufizuara dhe punonjës të tjerë të arsimit kanë aplikuar metoda dhe praktika, të cilat kanë lehtësuar dhe përsheptuar procesin e integritimit dhe gjithëpërfshirjes së fëmijëve me aftësi të kufizuara në kopshtet dhe shkollat e arsimit bazë.

Me ngritjen e **ekipit shumëdisiplinar** me bazë në Drejtorinë Arsimore në sajë të një **marrëveshjeje ndërinsitucionale**, identifikimi i fëmijëve me nevoja të veçanta arsimore dhe vlerësimi i nevojave të tyre, kaloi në kompetencat e kësaj strukture dhe synon trajtimin e aftësisë së kufizuar përmes qasjes **bio-psiko-sociale**. Pas rregjistrimit në kopshte dhe shkolla sipas udhëzimeve të komisionit shumëdisiplinar, fëmija kalon në kujdesin dhe vëmendjen e veçantë të grupit të vlerësimit brenda shkollës, i cili bazuar në rekomandimet e ekipit me bazë Drejtorinë Arsimore Rajonale punon për hartimin e **planeve individuale (PI)** dhe krijimin e kushteve të favorshme për të mundësuar arsim cilësor për këta fëmijë.

Save the Children ka ofruar dhe ofron modele të suksesshme në identifikimin e fëmijëve me aftësi të kufizuara siç janë zhvillimi dhe pilotimi i një databazë, koordinimi me shoqërinë civile, bashkitë, qendrat e shëndetit primar dhe prindërit për identifikimin e hershëm dhe regjistrimin e fëmijëve në shkollë.

Save the Children dhe Ministria e Arsimit dhe Sportit (MAS), **prej vitit 2004**, kanë bashkëpunuar fuqishëm në **zbatimin e arsimit gjithëpërfshirës** për fëmijët me aftësi të kufizuara. Në sajë të eksperiencës shumëvjeçare të zbatimit të modeleve të Arsimit Gjithëpërfshirës, një numër i konsiderueshëm fëmijësh me aftësi të kufizuara janë mbështetur në procesin e regjistrimit dhe pjesëmarrjes së plotë, në përmirësimin e rezultateve mësimore dhe në shoqërimin me shokët e tjerë të klasës në ambientin e shkollës publike.

Hartimi i Strategjisë Kombëtare të Personave me aftësi të kufizuara, aprovuar në vitin 2004 dhe Strategjia e Ministrisë së Arsimit dhe Sportit për edukimin, ishin hapa të rëndësishëm dhe favorizues për procesin gjithëpërfshirës në arsimin shqiptar.

Zbatimi i programit të Save the Children për arsimin gjithëpërfshirës ka sjellë **ndryshime të rëndësishme** veçanërisht në zhvillimin e modeleve e praktikave mësimore, kulturave dhe mentaliteteve gjithëpërfshirëse, në shkolla dhe komunitete dhe nxitjen e ndryshimeve ligjore dhe hartimin e politikave gjithëpërfshirëse në sistemin arsimor parauniversitar dhe koordinim ndërsektorial nëpërmjet ngritjes së strukturave mbështetëse në nivel lokal që ndihmojnë në realizimin e punës së drejtpërdrejtë me fëmijë me aftësi të kufizuara.

Save the Children gjatë implementimit të programeve dhe projekteve në fushën e arsimit gjithëpërfshirës ka punuar për ngritjen e kapaciteteve të mësuesve në shërbim, furnizimin e shkollave me materiale didaktike, ka prodhuar hulumtime të shumta për situatën e fëmijëve me aftësi të kufizuara, ka përmirësuar infrastrukturën shkollore, si edhe ka dhënë mbështetje për universitetet në rishikimin e kurrikulave.

Konventa e Kombeve të Bashkuara për Personat me Aftësi të Kufizuara hyri në fuqi në 3 Maj 2008 duke u ratifikuar nga 20 shtete. Kjo Konventë është konsideruar nga Kombet e Bashkuara si traktati më i rëndësishëm i të drejtave të njeriut të shekullit të XXI që adreson të drejtën në fushën sociale, politike, ekonomike dhe kulturore. **Konventa mbështet e komplementon fuqishëm Konventën e të Drejtave të Fëmijëve.** Ajo thekson se barrierat në gëzimin e plotë të jetës nuk qëndrojnë në kufizimin e aftësive në vetvete, por në qëndrimet fizike, sociale dhe kulturore që këta persona hasin çdo ditë duke përfshirë dhe fëmijët. Konventa theksoi si kurrë më parë detyrimet e qeverive ndaj personave me aftësi të kufizuara dhe ofroi mekanizma e instrumenta matës të aplikimit të këtyre parimeve.

Përkushtimi i qeverisë shqiptare për ratifikimin e saj në **22 Dhjetor të vitit 2012** pohoi e dëshmoi nevojën urgjente të aksioneve direkte në mbështetje të proceseve gjithëpërfshirës e të parimeve bazë të respektimit, të barazisë sociale duke luftuar diskriminimin institucional dhe atë shoqëror. Gadishmëria e qeverisë shqiptare dhe në veçanti e Ministrisë së Arsimit dhe Sportit dhe Ministrisë së Mirëqënies Sociale dhe Rinisë falë përpjekjeve të përbashkëta me organizata jo-qeveritare i kanë hapur rrugë mundësive të barabarta për arsim fëmijëve me aftësi të kufizuara.

Eksperienca **disavjeçare e bashkëpunimit të Save the Children dhe Ministrisë së Arsimit dhe Sportit** në promovimin dhe mbështetjen e arsimit gjithëpërfshirës ka rezultuar efikase dhe ndihmuese për përmirësimin e procesit të politikëbërjes dhe kuadrit ligjor lidhur me çështjet e edukimit të fëmijëve me aftësi të kufizuara. **Arritje e rëndësishme në fushën e hartimit të politikave është përgatitja e draft-ligjit për Arsimin Parauniversitar (miratuar në 13 Korrik, 2012).** Save the Children u angazhua në formulimin e disa pjesëve kyç të këtij legjislacioni, i cili parashikon lehtësira për Arsimin Gjithëpërfshirës të fëmijëve me aftësi të kufizuara në nivel kombëtar.



Një panoramë e programeve të arsimit gjithëpërfshirës Save the Children 2000 – 2015

Projekti “Arsim Special i Integruar” filloi të zbatohet në Shqipëri në vitin **2000-2003** në qarkun e **Tiranës** dhe **Elbasanit (Tiranë, Elbasan, Librazhd, Peqin)** për identifikimin e hershëm dhe mbështetjen direkte të fëmijëve me aftësi të kufizuara. Duke filluar **nga viti 2000 Save the Children mbështet krijimin e grupeve shumëdisiplinare dhe realizon identifikimin e hershëm dhe mbështetje direkte** të fëmijëve me aftësi të kufizuara dhe vështirësi në të nxënë.

Në vitin **2006-2008** Save the Children nis zbatimin e programit të “Arsimit Gjithëpërfshirës” bazuar në **Indeksin e Gjithëpërfshirjes** në rajonet Tiranë, Berat e Librazhd, për t’u shtrirë më tej në vitin **2008** në rajonin e Korçës e më pas në Vlorë dhe Gjirokastrë duke synuar gjithëpërfshirjen e fëmijëve me aftësi të kufizuara në shkollat dhe kopshtet e zakonshme duke sjellë si rezultat përfshirjen e 140 fëmijëve me aftësi të kufizuara në shkollë në vitin **2006**, si edhe 123 fëmijëve në shkollë dhe 83 fëmijëve në kopshte gjatë vitit **2007**.

Duke filluar nga viti **2008 – 2012** u mundësua pilotimi i ekipeve shumëdisiplinore për vlerësimin e fëmijëve me aftësi të kufizuara pranë Drejtorive Arsimore Rajonale në Gjirokastrë dhe Vlorë dhe nga viti **2013** e në vijim me ngritjen e kapaciteteve të Komisioneve shumëdisiplinore në Drejtoritë Arsimore Rajonale Durrës; Elbasan; Korçë; Gjirokastrë; Vlorë; Peshkopi dhe ZA Burrel dhe duke ofruar ndihmë për mësuesit mbështetës për periudhën **2008 – 2012** në shkollat pilot në Korçë, Vlorë dhe Gjirokastrë.

Si rezultat i punës dhe veprimtarive të projektit **“Arsimi Gjithëpërfshirës për fëmijët me aftësi të kufizuara në sistemin parashkollor dhe 9 vjeçar”** të zbatuar në vitin 2009 në Vlorë, Korçë, Gjirokastrë dhe Berat, 132 fëmijë me aftësi të kufizuara u regjistruan në shkollat e kopshtet e projektit ndërsa 365 fëmijë të tjerë u mbështetën me plane individuale arsimit mbi bazat dhe nevojën e potencialit të fëmijëve të cilat u hartuan në bashkëpunim me mësuesit, prindërit dhe fëmijët.

Një nga praktikat më të mira të zbatimit të strategjisë 2009-2012 ishte **ngritja dhe fuqizimi i ekipeve shumëdisiplinore me pjesëmarrjen e përfaqësuesve të institucioneve që punojnë drejtpërdrejt me fëmijët dhe për fëmijët me aftësi të kufizuara**. Për të konkretizuar këtë rrjet bashkëpunimesh në kuadrin e projektit Arsim Gjithëpërfshirës që në vitin 2011 u bë i mundur ngritja dhe konsolidimi i dy ekipeve të Drejtorive Arsimore në qytetet Korçë dhe Vlorë për të mbështetur procesin e gjithëpërfshirjes së fëmijëve në kopshte dhe shkolla. Në vitin 2012 ky ekip u ngrit dhe u pilotua edhe në rajonin e Gjirokastrës. Bazuar në modelet e pilotuara dhe zbatuara nga Save the Children ekipet shumëdisiplinore janë tashmë ngritur nga MAS në të gjitha rajonet e Shqipërisë.

Gjatë periudhës strategjike 2012 – 2015, **Save the Children ka ofruar trajnime të shumta të cilat kanë synuar ngritjen e kapaciteteve profesionale, pedagogjike dhe ligjore** të specialistëve të IZHA; IKAP; dhe Drejtorive Arsimore Rajonale në Durrës; Elbasan; Korçë; Gjirokastrë; Vlorë; Peshkopi dhe ZA Burrel; në lidhje me vlerësimin e nevojave edukative të fëmijëve me aftësi të kufizuara dhe vështirësi në të nxënë me praktikat gjithëpërfshirëse në klasë dhe në shkollë.

Save the Children nga 2013 e në vijim rrit numrin e përfituesve edhe për rajonet Durrës, Elbasan, Burrel dhe Peshkopi. Programi **“Arsimi Gjithëpërfshirës”** rrit dimensionin e tij duke synuar zhvillimin e plotë të potencialit intelektual e fizik dhe përmirësimin e cilësisë së jetës së fëmijëve me aftësi të kufizuara për t’i përgatitur për integrim të plotë në shoqëri dhe në tregun e punës.

Vendosja e Arsimit Gjithëpërfshirës si një nga prioritetet e periudhës strategjike 2009-2012 të Save the Children tregoi dhe njëherë vendosmërinë, vazhdimësinë dhe qëndrueshmërinë e projekteve mbi gjithëpërfshirjen si një nevojë urgjente e shkollës dhe shoqërisë shqiptare.



Save the Children në vitin 2014 filloi zbatimin e një programi holistik të gjithëpërfshirjes, këtë radhë në 7 rajone të Shqipërisë përfshirë edhe zonat rurale: Peshkopi, Burrel, Durrës, Elbasan, Vlorë, Korçë dhe Gjirokastrë duke dhënë mbështetjen e saj në 14 shkolla dhe 14 kopshte në rajon. Projekti **“Arsim Gjithëpërfshirës për Fëmijët me Nevoja të Veçanta Arsimore në Shqipëri”** e mbështetur nga Koperacioni Italian për Zhvillim / Ministria e Punëve të jashtme e Italisë dhe e zbatuar në bashkëpunim me Ministrin e Arsimit dhe Sportit dhe shoqatën MEDPAK është projekt i shtrirë në tre vite dhe ka për synim promovimin e arsimit gjithëpërfshirës me ndërhyrjet e saja në tre fusha:

- 1 Lehtësimin e aksesit të fëmijët me aftësi të kufizuara (AK) dhe vështirësi në të nxënë (VN) në kopshte dhe shkolla 9-vjeçare**, duke ngritur mekanizma të identifikimit të hershëm të fëmijëve me aftësi të kufizuara dhe vështirësi në të nxënë; ndërgjegjësimin e prindërve, personelit të shkollës, komunitetit dhe mbështetjen e komisioneve në nivel rajoni dhe shkollë për vlerësimin e fëmijëve, hartimin e planeve individuale si dhe heqjen e barrierave arkitekturore dhe furnizimit të shkollave me materiale didaktike.
- 2 Përmirësimin e kompetencave të të gjithë aktorëve si në nivel qendror edhe atë lokal dhe promovimin të figurës së mësuesit ndihmës në shkollë**, përmes ngritjes së kapaciteteve të komisioneve shumëdisiplinare vlerësuese në nivel rajoni dhe shkollë, dhe mësuesve në shërbim mbi metodologjinë e Klasifikimit Ndërkombëtar të Funkcionalitetit dhe ndërtimin e Planeve Individuale si dhe mbi arsimin gjithëpërfshirës dhe metodologjitë e mësimdhënies gjithëpërfshirëse dhe bashkëpunimin me prindërit dhe komunitetin. Për më tepër nëpërmjet programit të Save the Children, ekspertë nga Universiteti i Bolonjës (Itali) po bashkëpunojnë me Universitetet Shqiptare të Qyteteve të Korçës dhe Elbasanit për të analizuar dhe rishikuar kurrikulat universitare duke përfshirë në programet ekzistuese të edukimit arsimin gjithëpërfshirës dhe duke ofruar kurse të veçanta në këtë tematikë. Si rrjedhojë e këtij bashkëpunimi janë hartuar edhe programe të studimeve post-diplomë mbi Arsimin Gjithëpërfshirës dhe Mësuesin Ndihmës. Në vazhdimësi, përmes vizitave studimore në Kosovë dhe në Itali do ngriten kompetencat e stafit të shkollës dhe strukturave rajonale mbi zbatimin e modelit të Indeksit të Gjithëpërfshirjes.
- 3 Promovimin e një kulture gjithëpërfshirëse dhe reduktimin e stereotipeve negative** si në komunitet, familje, shoqëri civile dhe në institucionet vendore, duke krijuar mekanizma bashkëpunimi në krijimin e kulturës dhe praktikave gjithëpërfshirëse në shkollë dhe shoqëri, dhe duke zhvilluar aktivitete ndërgjegjësuëse si në nivel shkollë dhe komuniteti edhe në nivel kombëtar përmes fushatave ndërgjegjësuëse.

Gjithashtu rëndësi e veçantë i është kushtuar integritit të praktikave mësimore bazuar në metodologjinë me në qendër nxënësin dhe programet edukative individuale; krijimit të materialeve burimore dhe kushteve të tjera ndihmëse mbi përshtatshmërinë e mjediseve mësimore e ndërtimore të domosdoshme për sigurimin e një arsimit cilësor, si dhe pajisja me klasa burimore dhe ndërtimi i rampave dhe tualeteve të përshtatura në shkollat e kopshtet e projektit.

Disa nga materialet më të rëndësishme të hartuara nga Save the Children të cilat kanë pasur një impakt të rëndësishëm në zhvillimin dhe implementimin e arsimit gjithëpërfshirës në Shqipëri janë të renditura si më poshtë:

- 1** Analizë e situatës së fëmijëve me aftësi të kufizuara në Shqipëri 2003
- 2** Dokumentimi i Arsimit Gjithëpërfshirës 2009- 2012
- 3** Edukimi Gjithëpërfshirës në Shqipëri Studim Analitik
- 4** Analiza e Situatës së Fëmijëve më Aftësi të Kufizuara në Shqipëri
- 5** Praktikat Gjithëpërfshirëse në Sistemin e Arsimit Parauniversitar –Raport mbi Analizën e Situatës
- 6** Strategjia dhe plani i veprimit për arsimin gjithëpërfshirës për fëmijët me Aftësi të Kufizuara
- 7** Manuali i procedurave të shkollës në ndihmë të gjithëpërfshirjes së nxënësve me Aftësi të Kufizuara
- 8** Më shiko, Më Dëgjo – Një udhëzues mbi përdorimin e Konventës së OKB –së mbi të drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara për të çuar përpara mbrojtjen dhe të drejtat e fëmijëve.
- 9** Roli i Ekipeve në hartimin dhe zbatimin e Planeve Edukative Individuale